

VENDIM
Nr.55, datë 21.1.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË, NË SHKOLLËN E LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “KRISTAL”, FILIALI FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare private “Kristal”, filiali Fier, të dy programeve të studimit, të ciklit të parë. Programet e studimit, që do të ofrohen në formën e studimeve me kohë të plotë, do të jenë:

- a) Drejtësi;
- b) Infermieri.

2. Këto programe studimi do të jenë të njëjta me programet e studimit, që shkolla e lartë universitare private “Kristal”, ofron, përkatësisht, në Fakultetin e Drejtësisë dhe në Fakultetin e infermierisë, në selinë qendrore të saj, në Tiranë. Ato do të realizohen, përkatësisht, me 180 kredite dhe kohëzgjatja e tyre normale do të jetë tri vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), në fushat përkatëse të arsimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Kristal”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Shkolla e lartë universitare private “Kristal” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Kristal”, filiali Fier, duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha